

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 12”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, Z. E. Mema.**

Znj. M. Çelmeta: Përshëndetje! Sot më datë 12 shtator 2024 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit, për kërkesën ankimore nr. 12, depozituar pranë KQZ, me ankues me ankues zotin Astrit Fadil Kaziu, me objekt: “Kundërshtim i vendimit të KQZ i datës 13.08.2024, në lidhje me caktimin e shtetases Donika Ded Karina si anëtare e Këshillit Bashkiak, Peqin, nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor”. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14, të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në një prej tyre është shënuar kërkesa ankimore nr. 12 dhe shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre për caktimin e relatorit. Fillojmë me mbushjen e goglave. Viojmë me përzierjen e goglave dhe vazhdojmë me rendin alfabetik ngjithë duke filluar nga zoti Elvin Lako, zoti Elvis Çefa, zoti Ilirjan Rusmali, zoti Koli Bele, zoti Ledio Braho.

- | | |
|-------------------------------------|---|
| <i>Hapim goglën e parë,</i> | – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime. |
| <i>Hapim goglën e dytë,</i> | – Shiriti ka të shënuar, kërkesa ankimore nr. 12. |
| <i>Hapim goglën e tretë,</i> | – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime. |

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Hapim gogllën e katërt, – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Hapim gogllën e pestë, – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit për kërkesës ankimore nr. 12, relator është zoti Elvis Çefa.

Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

